

## INTERVISTË ME SHAZIJE GËRGURI HASANGJEKAJ

Prishtinë | Data: 25 Korrik, 2023

Kohëzgjatja: 75 minuta

Të pranishëm:

- Shazije Gërguri Hasangjekaj (e Intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Latra Demaçi (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zoja Shazije a mundeni me u prezentu edhe me na tregu diçka për historinë e familjes t'juj?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Unë jom Shazije Gërguri Hasangjekaj, e lindur me '45-tin prej babës Ajet Gërguri i cili ka qenë aktivist politik i njoftun. Osht' në luftë ka marrë pjesë në Luftën e Drenicës, ballit kombëtar, atëherë i thojshin ktyne që...

**Anita Susuri:** Ballistave.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ballistave (qeshë). 1947 osht' pushkatue. Dy vjet ka qenë në malet, kanë luftu por n'fund janë nxan me Gjjon Serreçin, Imer Berishën, Halim Spahin edhe shumë të tjerë që janë të pushkatun në Taukbahçe.

**Anita Susuri:** Ju keni qenë dy vjeçe atëherë, nuk e kujtoni, po m'tregut për rrëfimin e nanës t'juj si ka ndodhë krejt.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Mas pushkatimit t'babës, nanën e kanë largu prej shtëpije me tre fëmijë. Osht' strehue te Xhambazët për ni kohë derisa... ka pasë zanatin rrobaqepëse, ka ble ni shtëpi ku kena jetu edhe tash vllau ka jetu. Na ka shkollu me rrobaqepësi edhe vllaun edhe mu. Motra s'ka dashtë ta vazhdoj shkollën e mesme.

**Anita Susuri:** Më tregut edhe për, ma në detaje ku ka qenë shpija, si ju kanë largu prej shpisë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Shtëpija ka qenë në qendër, përballë kuvendit. Kur e kanë pushkatu babën na kanë largu prej shtëpisë krejtve. Kena pasë edhe hotelin në Lipjan, të cilin e ka marrë shteti. Nana osht' mundue, dihet kur i ki tre fëmijë, pa asni dinar, të ardhuna veç çka ka punu vet. Ka mbri me na shkollu. Në atë vit kur e kom kry shkollën e mesme të mjekësisë, kom shku në Beograd kom regjistru Fakultetin e Mjekësisë. Mas ni viti jom kthye pa bursë, pa kurgjo me financim të nanës.

**Anita Susuri:** Çfarë gjenerate ka qenë baba juj? Kur ka qenë i lindur?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Baba jem ka qenë 1903-ten, domethonë 40 vjeçar ka qenë në atë kur osht' pushkatu.

**Anita Susuri:** Domethonë 1903-ten... m'tregut që ka pasë bashkëpunim edhe me Naim Frashërin...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ai si 15 vjeçar kishte, ishte, i çetës Azem Bejtës i ishte bashkangjtitë. Naim Frashëri në Shqipëri edhe ka punu në Tiranë si, s'po m'kujtohet tash, agronom a nuk e di. Se e di që shkrun që ka qenë në Shqipëri. Ka jetu në Shqipëri. Ka lind në Kosovë po ka jetu... këta janë të shpërngulun prej Toplicës, fshati Gërgur kur i kanë përzanë atëherë. Tri herë janë shpërngulë familja ime. Prej katragjyshit, prej, janë ardhë në fshatin Dubovc afër Vuqitërrnes [Vushtri]. Masnej kanë shku për Turqi vitin 2020 nëse s'gaboju...

**Anita Susuri:** 2020?!

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** 1920-ten.

**Anita Susuri:** Po.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** 1920-ten. Masnej kanë shkue në Turqi prej Turqisë kanë shku në Fier. Atje janë vendos, atje kanë jetue. Mandej janë kthy prap në Prishtinë në '43-ten. Kanë qëndru derisa u pushkatu, ju ka bashkangjtitë ktyne luftave të Drenicës, ka qenë udhëheqës i Luftës së Drenicës. Ka udhëheqë në Lipovicë kongresin e Lipovicës bashkë me Gjon Sereçin, Imer Berishën dhe të tjerë plot me numëru emrat. Ka qenë ngusht edhe me këtë organizatën e NDSH-së të Shkupit, edhe me ta kanë bashkëpunu.

Ni vend shkrun, që tash historia po përsëritet, që kur ka ardhë puna m'u nda Kosova me Shqipëri gjoja se ju ka ndihmu këta anglezët dhe amerikanët po ata s'kanë reagu kurgjo. Ata kanë ardhë, si e kom lexu ni vend, kanë ardhë në Kosovë kanë lypë që m'u, shqiptartë m'u çu kundra gjermanëve se do t'ju ndihmojmë. Por në fund kur ka ardhë puna e ndasisë, s'kanë reagu kurgjo. Sa osht' e vërtetë, qashtu kom lexu (qeshë).

**Anita Susuri:** Ju thatë që paraprakisht, para se m'u angazhu baba juj në këto aktivitete, po mendoj gjatë Luftës së Dytë Botërore, ma herët kanë qenë ma t'pasun me çka janë marrë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Axha i babës është marrë me tregtar, ky ka qenë agronom. Kanë pasë pasuni të madhe edhe në Lipjan edhe në Prishtinë. Veç edhe këta të gjithë gati që kanë shku në mal asnjani s'ka qenë i pa shkollun, krejt kanë qenë me fakultete. Drejtori i gjimnazit të atëhershëm Gjon Serreçi, Halim Spahija edhe ai ka qenë tregtar i njohur. Të gjithë kanë qenë njerëz që kanë kontribu për

luftë pa marrë parasysh gjendjes ekonomike. Kanë dashtë ni Shqipëri të madhe për qata që kanë vazhdu edhe organizatat tjera ma tutje.

**Anita Susuri:** Sa fëmijë keni qenë ju?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Na ni djalë e dy vajza, tre fëmijë.

**Anita Susuri:** Thatë që pas pushkatimit të babës juve ju kanë nxjerrë nga shpija edhe ju kanë konfisku pasurinë atëherë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po. Vëllau ka qenë gjimnazist, Nuredini. Si e ka kry gjimnazin e kanë burgosë dhe e kanë dënu nantë vjet burg. Prej atyne pesë i ka majt, katër ia kanë falë. U dalë prej burgut, ka regjistru Fakultetin Ekonomik, e ka kry. Ka shku ushtar, si u kthy prej ushtrisë prap e kanë dënu, e kanë marrë në burg prap edhe pesë vjet tjera. Kështu që nantë vjet vllau ka qenë në burg. Ka qenë vazhdimisht i përcjellun. Kur ka dalë, kur ka hi gjithë ka pasë përcjellje kah po shkon, çka po bon.

**Anita Susuri:** E si e kujtoni ju fëmijërinë e ju? Domethonë keni qenë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po kom pasë plot veç kom qenë e re atëherë s'i kom regjistru disa gjana. Kom pasë disa të drejta të shkurtune. Për shembull, marrja e mujorës së autobusit nuk më ka taku. Në vitin 1964 e hapën Rilindja dhe shkrun ni artikull kundër babës tem, për njerëzit me ditë e kujna jom. Për dikon ni çikë e të mirit për dikon ni çikë e të keqit. Ni muj ditë kanë shkru si u bo ai kryetar i ballistave të Kosovës. Pejtoni është në prill të '64-tes apo në mars edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën sebro-kroate.

**Anita Susuri:** Osht' publiku çdo ditë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Çdo ditë, çdo ditë ni muj ditë, pejton ka qenë ni muj ditë ka qenë.

**Anita Susuri:** E çfarë përmbajtje ka pasë ai Pejton për dikond?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** S'kuptova çka the?

**Anita Susuri:** Çfarë përmbajtje ka pasë? Çka kanë tregu?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ato gazetata a?

**Anita Susuri:** Po.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Aii ato kanë shkru qysh ai ka qenë komandant, ka organizu Luftat e Drenicës, ka qenë kundra shtetit të Jugosllavisë. Rreptësisht krejt fajin ia lajnë atina se ai ka qenë udhëheqës i bandës. Ajo s'ka qenë bandë po ka qenë organizata e NDSH-së. Po për to ka qenë bandë derisa u nxan. Në Drenicë u strehu krejt kohën e në fund u nxan.

**Anita Susuri:** A ju ka tregu nana juj qysh ka ndodhë që e kanë nxan?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Gazeta ka shkru, gazeta ka shkru qysh osht' nxan po tash në shtëpi të njanit, qysh thojshin, e kanë strehue po aty e ka ditë vetëm i zoti i shtëpisë. E kanë shti në sanë dikun mrena shumë thellë. E kanë ardhë tri-katër here se dikush e ka lajmëru që osht' aty. Zakonisht lajmëron dikush, s'po dijna, ato organet. Kanë lajmëru, kanë thanë që osht' në shtëpi të filanit, osht' i mshefun. Kanë ardhë ushtria kanë hallakat, kanë hallakat s'kanë mujtë me gjetë.

Tri here janë kthy të njejtën shtëpi, por të tretën here ni vëlla i tyne nuk e ka ditë që osht' ai mrena. Ka thanë, "Shkoni deri në fund të sanës bre se na lodhët t'u hallakat". Ky ka qenë i përgatitun, ka pasë automat e krejt atje. Ka mujtë m'i mytë, nashta edhe e ka mytë dikond s'po di, prej ushtrisë. Por gjoja se ni plakë paska thanë, "Pashë gjinin që ta ka dhanë nana dorëzohu mos na merr n'qaf", edhe u dorëzu. Këto janë tash sene të gazetës, sa janë të vërteta nuk e di.

**Anita Susuri:** E ju si fëmi, thatë që, me punën e nanës t'juj keni arritë familja juj me bo ni shpi dikund?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po kena arritë edhe na ka shkollu, s'kena ni as mungesë të babës fare. Se në kohën kur u shkollu vllavi jem pak ka pasë djem të shkollun me prind, me te dy prindt. Po veç a kena dashtë me mësu. Nana ka qenë shumë për shkollë. Ka qepë, kurrë s'ka pasë pushim vetëm ka qepë, ka qepë. Kurrë s'kena vujtë për kurgjo as për bukë, as për veshje as për kurgjo. Kena ble qat' shtëpi. S'ka pasë nana as ndihmë sociale as kurgjo. 'Se osht' gruja e Ajetit, nuk bon me marrë kurgjo'. Na nuk e kena ndi mungesën e babës se nana ka punu shumë. Jena shkollu. Masi jom martu e kom kry edhe shkollën e naltë në Zagreb. Jom punësu në spital.

**Anita Susuri:** Në Prishtinë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Në Prishtinë, po. 45 vjet kom punu.

**Anita Susuri:** Flasim edhe për ato po po m'intereson edhe pak fëmijëria...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Fëmijëria, unë në shkollë të mesme iu bashkangjita organizatës që lypshim bashkim kombëtar. Kanë qenë shumë aktivista, unë kom qenë jo fort m'u marrë vesh e kujna jom edhe ku po sillna. Njëpërmjet ni shoqes i kom kry krejt ato punë se unë kom qenë gjithë e përcjellne edhe unë. E në qoftëse shkojsha unë nëpër mledhje e zbulojsha organizatën. Njëpërmjet ni

shoqes merrsha informata, detyra, qitshim pamfleta, 'Kosova Republikë!', qitshim flamuj për 28 nëntor. Këto kanë qenë aktivitetet tona.

**Anita Susuri:** Po du fillimisht me ju pytë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Edhe kom qenë në '64-ten po m'duket '64 kam qenë dy ditë e burgosur. Atë ditë kur u dënu Ademi, Adem Demaçi. Shkova me disa shoqe me ndëgju gjykimin, të nesrit jom burgosë.

**Anita Susuri:** A mundeni me m'tregu, po filloj edhe niherë prej ma herët kur keni qenë dikund në shkollë fillore...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** A kurgjo s'maj mend...

**Anita Susuri:** Sepse ka qenë periudhë pas Luftës së Dytë. Po më intereson a keni ndonjë kujtim qysh ka qenë Prishtina? Qysh ka qenë rrethi ku jeni rritë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Rrethi ku jemi rritë ka qenë i mirë. Mahalla jonë ka qenë Çeklik e njohur por shumica kanë shku për Turqi. '53-tin i lypshin armët, i malltretojshin njerëzit e shumë kanë qenë, kanë shku për Turqi. Se me të vërtetë ka qenë mahallë shumë e mirë. Mandej të shkretit fshatar që janë ikë prej fshatrave, prej belave kanë ardhë kanë ble se mahalla ka qenë shumë e mirë. Po shumë janë largu. Prej Prishtinës që kena qenë aty, pak shtëpi jemi. Tonat nja dhetë shtëpi s'jena. Novosellët... se shumica kanë shku për Turqi.

**Anita Susuri:** A e kujtoni ju këtë kur kanë shku? Familjet kur janë bajtë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** I kujtoj, pak i mbaj mend.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë për shembull?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** O' shumë qajshin, shumë qajshin se disa kanë qenë edhe me kushte të mira ktu po u dufshin me shkue. Disa ia njehshin vetës si turk e dojshin m'u largu. Se ma lehtë e ka pasë me thanë që jom turk se shqiptarë. Kanë pasë do të drejta pak ma të mdhaja. Kështu shumë jonë largue. Në shkollë sa kom qenë tetë vjeçare nuk kom vrejt gja që dikush më kqyrë me naj urrejtje a diçka. Ma vonë...

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë Prishtina e vjetër? Si e kujtoni?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Prishtina e vjetër e mirë ka qenë. Qitu ni qeshme e madhe çeklik osht' thirrë. Ka pasë ujë shumë të mirë, krejt kanë marrë aty. Kjo te Teatri Dodona edhe kjo ka qenë, po ka

qenë ni kohë si ambulante, injeksione jepshin. Rrugët më duket nuk kanë qenë me drita, në qoftëse s'gabo. Kom harru, qe 60 vjet. Shumë e mirë ka qenë, e du Prishtinën.

**Anita Susuri:** A ju ka ra ndonjëherë me shku kah qendra andej? Ose...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po, po. Hiç fort s'po m'kujtohet. E di që kanë qenë reklamat e filmit përballë Teatrit Kombëtar e ni rrugicë te poshtë u lëshojke do dyqane kanë qenë. Ni librari ka qenë në qendër që u blejshin librat, e ni rrugicë teposhtë. Knej prej Grandit e ma andej s'ka qenën ndërtim fare. Kanë qenë kasaphane, a dinë, ato që prej në mishnat. Prej Grandit anej ka qenë pa shtëpia.

**Anita Susuri:** Thojnë që tash te pjesa ku osht' universiteti, kampusi i universitetit ka qenë ni, si, llogor [kamp përqendrimi] në Luftën e Dytë Botërore, a ju kujtohet?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** S'e maj mend, s'e maj mend, nuk e di. Te teatri ka qenë diçka, nifar' nuk po më kujtohet çka ka qenë te teatri...

**Anita Susuri:** Ni xhami? Ka qenë edhe ni xhami atje?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, qe hiç s'pe maj mend. Edhe ata bash e kena diskutu nihere po s'e majsha mend.

**Anita Susuri:** Nuk e di a ka qenë, a e keni pa ju a jo, nuk po më kujtohet tash në cilin vit osht' rrënu ajo xhami. Si e mbani mend edhe jetën n'familje? Domethonë fqinjësi si kanë qenë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jeta, për fqinjësi shumë ma mirë se sot. Fqinjët shumë janë end ndërmjet veti. Megjithëse dera jonë gjithmonë ka qenë e regjistruar kush po hyn, po del. Po na kanë vizitu ilaket [kushërinjë]. S'kena pasë problem, për shembull, me thanë po frikësona me ardhë, s'po vijmë. Edhe me kojshi fort mirë e kena kalu. Veç sot u nda ajo jetë e dikurshme që për mendimin tem ka qenë ma e mirë. Tash janë ma të angazhun njerëzit, s'kanë kohë për këto gjana (qeshë).

**Anita Susuri:** Zonja Shazije, më thatë ma herët që n'vitin '64-'65 keni shku për Beograd...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po.

**Anita Susuri:** Tash po m'intereson ju si vajzë në atë, domethonë, në atë kohë ka qenë i kufizun numri i vajzave që janë shkollu e sidomos në Beograd. Qysh kanë qenë krejt rrethanat që u bo me studiu?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Unë masi e kreu shkollën e mesme të mjekësisë në '64-ten, vendosa me studiu mjekësi në Beograd. Konkurova për bursë po nuk më takoj bursi, dihej arsyeja. S'kom pasë të drejta unë si të gjithë fëmijë tjerë. Po nana tha, "Në qoftëse ki dëshirë ti me shku, unë të financoj".

Kështu që vendosa të shkoj në Beograd të studioj mjekësinë. U regjistrova pa problem, filloj viti shkollor, banova në ni internat në Beograd.

Por, mas ni kohe ishim në ushtrime të biologjisë, kur ni asistente prej sallës ishim ndoshta 100 vet në ushtrime, e gjeti mu me m'pytë, "Ku t'punon baba?" Unë meta, thashë, "Nuk kom babë". Prej asaj dite u demoralizova për me qëndru në Beograd. Thashë prej ditës të fillimit mos të thotë diçka të dyshimt, p'e dijnë e kujna jom, mos t'kom fort peripeti.

Kështu që në shtator ma nuk shkova as në provime. Në provime kom hy të qershorit, të shtatorit nuk shkova. Edhe kurrë s'kom marrë as diplomën e shkollës të mjekësisë, atje më ka mbetë. Kurrë s'jom shku me marrë. Jom tërhekë s'kom shku ma me vazhdue. Këto shoqatën në përpjekje kom shkue me marrë pjesë. Edhe aty kisha pasë ni përcjellje. Ma tërhjeken vrejten disa shqiptarë që, "Kujdes qysh po silllesh se ktu e ke ni përcjellje", thashë, "Në qoftëse rri unë pesë vjet në Beograd vazhdimisht t'u më përcjellë dikush atëherë ma mirë të kthehna në shtëpi".

**Latra Demaçi:** Në këtë organizatën përpjekja, aq ju ka ra me pa, a ju kujtohen disa...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ajo ka qenë organizatë kështu kulturore, veç ka qenë edhe shumë me interes patriotik. Ka qenë...

**Anita Susuri:** Ajo u formu në Beograd?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Në Beograd ka qenë si organizatë kulturore. Jo me recitu vjerrsha, jo me këndu, jo me sen... po ka pasë krejt përmbajtje tjetër. Ka qenë e Mustafë Cakaj, shumë njeri patriot. Ai e ka formu me i bashku shqiptarët. Megjithëse aty ka pasë njerëz që, disa raste njeri ma shumë duhet m'u rujtë prej shqiptarëve se prej tjerëve. Se nuk e dinë me kënd ki kontakt. Kështu që ajo ka qenë organizatë shumë, shumë bamirëse në favor të shqiptarëve. Po nuk e di a ekziston ma a jo. Ai e ka mbajt vite me radhë ka ekzistu përpjekja.

**Anita Susuri:** Po më intereson edhe përshtypja juj që keni shku për Beograd që keni udhëtu atëherë. A ka qenë hera juj e parë që keni udhëtu ma larg?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, hera parë për Beograd. Jo s'jom frikësu. Kom shku me tren, s'jom frigue.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë krejt udhëtimi?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Mirë, mirë. Atëherë s'ka pasë diçka, ndoshta edhe s'kom ditë m'u frikësu. Kom shku me adresë ku jom regjistru... a, niherë, tash m'u kujtu. Herën e parë për m'u regjistru kom shku me nanën. Për herë të parë me nanën tem kom shkue në Beograd. E lash nanën me

më prit në qendër para shpisë të mallrave. Thashë, “Unë po shkoj po regjistrona”, edhe i numërova stacionet deri në Fakultet të Mjekësisë. I dorëzoja dokumentat edhe ashtu u ktheva.

Kur u ktheva, kisha gabu stacionet. S’e gjejsha nanën. E m’kapi ni panikë. Kuku tash e fajësojsha nanën pse e ka ndrru venin. Ajo gruaja ish ulë s’kish livrit fare. Unë lyp, lyp, kuku m’hupi nana, m’hupi nana, çka me ba? Sillu poshtë e naltë. Kur t’u u en herë knej e andej isha zbrit ni stacion ma përpara. Dikur e gjeta thashë, “Pse bre e ke ndrru venin?” Tha, “Une qitu m’ke lonë, qitu m’gjete”. Deshta me ia lanë fajin asaj, kisha numëru gabimisht stacionet. Masnej herën e dytë kom shku vet.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë jeta në Beograd për juve si studente?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po këto cimeret i kom pasë krejt serbe. Kanë qenë krejt prej Jugosllavisë. Plot kanë qenë. Bile s’di ku e kom ni fotografi me krejt ato në dhomë, nja pesë veta jena. Qashtu msojshim në dhomë. Unë ma tepër përgatitsha në internat vet, m’bijke ma lirë. Kaniherë shkojsha hajsha po nuk shkojsha aty ku mbarohen me t’derit po ishte nifar’ menze për muslimant, këta arabët. E qaty u ushqejsha. Po shumicën kom përgatitë vet.

**Anita Susuri:** Nëatë kohë ka pasë, e përmendet edhe ju, edhe prej vendeve t’ndryshme...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po ka pasë shumë. Ka pasë shumë arab studenta, shumë.

**Anita Susuri:** Si ka qenë kjo për juve? Domethonë me pa kultura të ndryshme me ni vend.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** S’mu ka dokë kurgjo e çuditshme (qeshë). S’mu ka dokë.

**Anita Susuri:** A keni pasë shoqni atje? A keni dalë? A ka pasë naj aktivitet?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo ka pasë veç s’jom... qat’ përpjekje që kom shku une. Ni herë a dy kom qenë në film jo kërkund s’kom shkue veç fakultet në shpi, po mendoj internat.

**Anita Susuri:** Cili vit that’ që jeni kthy?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** ‘65-tes. ‘64. N’fund të ‘65-tes jom kthy.

**Anita Susuri:** Pastaj këtu keni vazhdu apo jeni punësu?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jom punësu ‘65-’66 mandej ‘67 jom martu. Edhe m’ka brejt ajo që mos me nejt veç me shkollë të mesme jom shku e kom kry në Zagreb atëherë shkollën e naltë. E martune kom qenë edhe i kom pasë fëmity. E krevashkollën e naltë në Zagreb masnej fillova qat’ degën që e kom kry shkollën e naltë.

**Anita Susuri:** Në cilin vit në Zagreb keni shku?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** ‘70-ten më doket, ‘73-ten në qoftëse s’gabo. Veç mirë kena kalu. Kena pasë punë shumë të suksesshme. Kaniherë thom ma mirë se puna e mjekut u kanë. Se t’u ka pa suksesi. Ajo punë është shumë e mirë kur t’shihet suksesi. Kabinetin e ortoptikës kena ushtru fëminë. Kena qenë katër shoqe. Dy kanë qenë të Prizrenit e katër kena qenë të Prishtinës.

**Anita Susuri:** E në Zagreb kur shkut, tash ka qenë ni periudhe ma ndryshe...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo në Zagreb s’ka pasë...

**Anita Susuri:** Po ka qenë edhe ‘74-ten për shembull...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo ndryshe. Ka ra [Aleksandër] Rankoviqi... po jo ndryshe ka qenë në Zagreb po edhe nuk u frikësojsha për kurgjo. Po edhe në Beograd nuk jom frikësu se s’dishim m’u frikësu.

**Anita Susuri:** E në...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Veç s’po m’kujtohet bash në detale qikjo që kom qenë në burg, a kom qenë meniherë kur e kom kry maturën. Po sigurisht kur e kom kry maturën se qysh kisha shku në shkollë unë mandej kur e kishin ditë që jom konë në burg. Qajo s’po m’kujtohet.

**Anita Susuri:** Ju thatë që n’fund të ‘65-tes jeni kthy prej Beogradit në Kosovë edhe keni fillu punën. Mirëpo po m’intereson, a ka qenë edhe kjo koha kur keni fillu aktivitetet?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, koha ka qenë e shkollës të mesme.

**Anita Susuri:** Prej shkollës të mesme?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Aty e kom ndërpre masnej. Veç kështu kom qenë, për shembull, në mënyrë indirekte sidomos pacientave me ju ndihmu. Shumë ma kanë pa hajrin, sidomos në të ‘90-ten, kur pacientët shumica kanë dalë prej pune prindërit e krejt kanë qenë pa librezë. Krejtve ju kena dalë në ndihmë. ‘Kush ka librezë merrjani dikujna, ejani’. E kena ditë që librezë nuk është e tyre.

Më kujtohet ni rast shumë interesant ni fëmisë e ka marrë librezën e huj, tash i ka thanë nana, “Mos fol”, na i pritshim fmitë se si msuse kena qenë, ushtrimet grupore. Po i thom, “Si e ke emrin?” “Ndal ta pys nanën” (qeshë). Se e kishte librezën e huj. Po i thom, “S’ka problem ti hiç mos e pytë nanën. Qysh të thrrasin te shpija?” Edhe aty... e na kanë pa hajrin shumë njerëz qaty.

Kurrë kërkënd s'kena shti me pagu kurgjo. Se ushtrimet kanë qenë sende që zgjasin. Ni fëmi ma së paku ni muj ka ardhën. Kështu që kumeditë sa me pasë pare, s'ka pasë mundësi me pagu. Shumë, shumë na kanë pa hajrin. Në punë te na, kërkush s'ka thanë s'po muj m'u kqyrë se s'kom librezë. Me të vërtetë qata kuadri osht' duft sa ma shumë m'i shkollu shqiptartë që m'i nxon venat e punës. Që mos të largohen le t'rrijnë se nuk din kujna ia sheh hajrin. Ka edhe asi tjerë po ka që ndihmojnë shumë. Shumë kena ndihmu popullit qato vite kur s'ka pasë librezë.

**Anita Susuri:** Po du m'u kthy te aktiviteti, ka qenë edhe vëllau juj i përfshin pastaj?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo vllau im nuk ka qenë. Unë kom qenë në klasën e gjashtë apo të shtatën kur osht' burgosë vëllau. Ai ka qenë shumë aktivist me Ademin me këta Novosellët me krejt ai ka qenë. I ri ka qenë edhe ai 19 vjeçar. I ka shku krejt jeta nëpër burgje. Ai... se s'po muj e thom veç në qoftëse u rreh dikush ni shuplakë, ai u rre tri edhe për babën edhe për veti. Të gjithë tjerët kanë kalu ma lehtë se vllau jem, se i ka pasë edhe pasojat përpara. Kështu që na u duft me qenë shumë t'kujdesshëm për disa gjana, që t'mos na sheh kush çka po bojmë. Ai e ka pranë edhe n'gjygj krejt, "Unë e kom ba..."

**Anita Susuri:** Nëse mundeni ma shumë me na përshkru kshu për qato aktivitete? Si në bashkëbisedim qashtu.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Unë kom pasë shumë kujdes që t'mos m'sheh kush që po mirrna me këto punë. Për shkak që mos me dëmtu organizatën se nëpërmjet meje shumë lehtë kishin ardhë deri te zbulimi. Krejt nëpërmjet Elhamës, ajo po m'duket ka qëndis flamuj. Ajo nëpërmjet dikujt m'ka thanë bone këtë, bone atë. Sidomos m'i qit' pamfletat për 28 nëntor, ata e kena pasë gjithqysh, mos me harru. Me i qit' flamuj nëpër shtëpija kur e dishim që janë njerëzit ma patriotat. Krejt i qitshim para mëngjesit, mos me na zbulu kush.

Mandej '65-ten, '64-ten në fund, ish t'u u dënu Adem Demaçi, unë i mora do shoqe. Unë nuk i mora shoqet me shku me organizu diçka, se s'kisha asi fuqie që muj unë me organizu diçka. Thashë, "A po vjen dikush me mue? Po shkoj me ndëgju gjykimin e Ademit?" E di për Elhamën që kom shku, për dikond nuk po m'kujtohet...

**Anita Susuri:** Mejreme Berisha mos?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Edhe Mejremi ka qenë, po s'di a ka qenë Mejremi atë ditë me mu. Se Mejremi ka qenë aktiviste e madhe. Kur nesrit kah ora 04:00 n'mëngjes, ky kerri i policisë para derës tonë. Bom, bom, bom {onomotope} drejtën me thanë jom frikësu shumë. Se na e kena pasë traum prej vllaut, qat' kohë e merrshin. Vijshin e bojshin shpijen hallakam. Kur po m'thojnë mue, "Vishu hajde me ne". Meta, s'mu kujtojke. Tash me m'zbulu s'ka mujtë kërkush se s'e kanë ditë, rrallë kush e ka ditë.

Shkova, m'shtijnë n'burg. Më majtën dy ditë. Më lshun pa kurfar' dokumenti as kurgjo hiç. S'guxojsha as me pytë pse erdha. Po thashë t'u dalë hajt nashta kurgjo s'më bojnë. Thashë, "M'falni, për çfarë arsye kom qenë ktu?" Tha, "Ke dashtë me organizu protestë pse po gjykohet Adem Demaçi". Ma dha ni letër me nënshkru, çka kom nënshkru kush guxojke me lexu çka po nënshkrun. E kom nënshkru, zoti e ditë çka kom nënshkru (qeshë). Ma nuk më kanë thirrë kurrë veç që vazhdimisht kom qenë... tash m'vjen çudi, se unë masanej kom shku në Beograd me studiu. Qysh kom pasë kurajon me vendosë me shku në Beograd mas asaj burgosje me shku atje? Tash m'vjen çudi.

**Anita Susuri:** E burgosja që ka ndodhë, a ju kanë mbyllë pastaj në Prishtinë a në sekretariat?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ja, ja këtu në qendër u konë burgu, qaty më kanë çu. Me ni dhomë me Elhamën kena qenë. Mejremi veç ka ardhë atë natë, masnej a e kanë lëshu a çka u bo nuk di kurgjo për të. Atë e kanë marrë prej dhomës. Unë Elhamja kena qenë. Elhamja më doket ka vazhdu, a ka qenë dhetë ditë tash nuk e di, qashtu më ka thanë masi kom dalë unë. Me ni dhomë. Ishin do Fazli Grajçevca nuk e di kush ka qenë n'qat kohë. Elhamja ma me përvojë, i dijkë këto sende. I mshojke murit të dhomave, thojkë, "Atje ka shqiptarë, në atë anën tjetër". Njisoj u nijkë piskama, nashta që janë ardhë i kanë rreh, i kanë pru të rrehën a nuk e di, detalet nuk i di.

**Anita Susuri:** E qysh kanë qenë kushtet?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ni dhomë e vogël, o zot mos provo kërkënd. Ni qyp aty në skej. Na jepshin për dritare do bukë me ni gjellë, katastrofë. As s'më kujtohet a kom hunger a s'kom hunger, kurgjo s'më kujtohet, kurgjo.

**Anita Susuri:** E kur keni dalë, a ju kujtohet shqetësimi i nanës juj ose reagimi i saj?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kurgjo... jo jo kërkush s'më ka prit te dera. Vet kom dalën. As nana s'e ka ditë kur po vi as kurgjo. Kur erdhën m'tha, "Hajde dil". Se as tesha s'më patën pru hala as kurgjo, qysh kom ardhë prej në mëngjes që m'kanë marrë që jom veshë në 04:00 në mëngjes. Shkum aty në zyre poshtë, ma dha ni letër me nënshkru. E nënshkrova as s'e lexova.

Kish qenë ni letër plot e mushne me shkrime edhe thashë a te pys pse erdha pse s'erdha? Hajt thashë p'e pys nashta s'bohet diçka ma e keqe (qeshë). Kur i pyta thashë, "Arsyjen që jam unë këtu?" Tha, "Ke dashtë me organizu protesta për gjykimin e Adem Demaçit", thashë, "Nuk e di që kom dashtë me organizu, veç kom shku me përcjellë gjykimin çka po bohet". Erdha në shtëpi. S'më kujtohen fare detalet ma tutje. Hiç.

**Anita Susuri:** E këtu që keni vendosë flamura qysh...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kanë qenë të vegjël. Flamurat kanë qenë të vegjël me ni dru anash. I vjerrshim nëpër shtëpija ku ishin këta pak ma patrioti. Qitu rreth lagjës, unë s'kom shku ma larg. Nashta dikush ka shku ma larg, unë jo. Rreth lagjes.

**Anita Susuri:** A keni dalë herët në mëngjes apo?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po. Kah ora 05:00 mos me t'pa kush. T'pa dikush që t'pa... tash me kqyrë holl e holl... u zbulu masnej kjo organizata jonë. Ky Rakovica Hyseni ata krejt janë konë njerëz me t'vërtetë, po me kqyrë nuk e di veç kur ta kqyrsh si përfundim, dikush i zbuloj prej shqiptarëve. Se ai serbi s'ka ardhë me kqyrë nëpër mbledhje çka po bohet. E qajo shumë keq.

**Anita Susuri:** A keni pasë edhe mbledhje?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Këta në organizatë kanë pasë, unë jo. Kanë pasë mbledhje shumë shpesh kta veç m'tregojshin masnej. Se jo, s'kom guxu kurrë. Se thojsha dikush më përcjellë... ka pasë, organizata ka qenë fort e madhe. Ka qenë shumë e madhe, kanë pasë mbledhje, çka me bo ma tutje, krejt ka qenë puna e bashkimit kombëtar. Krejt për qata kanë asi... me bo ni Shqipëri të madhe. Janë mbytyë gjinja, kanë vdekë bile.

Fazli Grajçevci si sot më kujtohet. E kanë marrë n'burg edhe kanë thanë, "Valla s'kthehna gjallë", mas dy dite ka qenë i vdekur. E kanë pru në spital, nuk më kujtohet te kush ka lypën me ia nënshkru kishë ka vdekë prej egjelit. Ni mjek, nuk e di a ka qenë Ali Sokoli a ka qenë Doktor Deda, s'kanë pranue që me nënshkru që ka vdekë prej smundjes normale.

**Anita Susuri:** Ali Sokoli po m'doket ka qenë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Edhe Doktor Deda ka qenë shumë patriot, shumë, shumë, shumë. Kena pasë...

**Anita Susuri:** Këto traktet që i keni shpërnda, a ju kujtohet çka kanë shkru?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kurgjo, kena shkru veç "Kosova Republikë!" Atë e kena pasë, "Kosova Republikë!" Edhe e knaqëm tash me Kosova Republikë. Qikjo po më bren' shumë tash. Jo për diçka se unë jom për të gjitha partitë, secili që të punon osht' shqiptarë kryesorja. Po çka na ka hi kjo xheloz ndërmjet veti, publikisht du me thanë, po më pengon. Kur duhet s'kena qenë ma të nevojshëm m'u bo bashkë. Me ni mendim të përbashkët e çka t'i bjen mend dikujna a e ka mirë a keq nuk e di.

Unë s'po thom për veti a e ka mirë a keq, po ata. Nuk mendojnë a e ka mirë a keq, po po du me bo qysh të thom une. Duhet të gjithë m'u bashku. Unë kom qenë gjithë prej asaj që kush osht' i mirë mos me ia honger hakun. Le të osht' edhe armiku jem. Në qoftëse e meriton ai me konë udhëheqës edhe i njeh

gjanat mirë, ka talent, ka shkollë, ka dije të madhe. Se të gjithë nuk kena dije të madhe, na mujna me lexu me sen po, disa sene janë të lindura. E dikush ata që e lexon dinë me komentu fort mirë.

Po nuk di çka osht' kjo xhelozia e jona. Qita publikisht e kisha thanë për të gjitha partitë. Le t'i lojnë xhelozinë, le ta kqyrin shtetin, mos ta çojnë posht shtetin për kurgjo hiç. Prej që e mbaj mend njerëzit janë burgosë për qit' Kosovë Republikë. Prej që e mbaj mend unë fëmijë, gjenerata mas gjenerate janë burgosë, gjenerata mas gjenerate kanë vdekë në burg për qit' asi... e tash mos me ditë me rujtë këta... për mu të gjithë janë të mirë, kërkond s'muj me thanë të keq po leni njerëzit te kallxojnë punën e vet sa dijnë. Mos i ndërhyjni n'asni sen.

Bile unë, se krejt familjen e babës e kom në Shqipëri, e m'ka vdekë para ni vjeti djali i axhës të babës. Ai ka qenë shumë, shumë ju ka ndihmu shqiptarëve edhe ka pasë udhëheqje në Shqipni të Kosovës. Ai u konë si kryetar. Refugjatëve, tepër ju ka ndihmu. Kur qishtu thojsha, "Ti je bija e Ajetit, çka po fol kështu?" "Po foli more, s'ka lidhje kush vjen udhëheqës. Le ta mbajnë" (qeshë) "le ta mbajnë mirë".

Tash momentalisht osht' Albini, pse s'i ndihmojnë me kallxu a po mujna me mbri dikund a jo e jo me iu gjujt djalit krejt, kush t'i bjen mend. Nashta e kanë ata të drejtë që po i gjuhen po duhet me kqyrë edhe antë pozitive diçka. Kërkush s'munesh me ditë kush osht' ma i miri. Se shumë osht' i mirë me kanë kur je në kushte normale, po osht' vështirë tash. Tash kena ardhë m'i mshu murit me gjoks. A mshohet muri me gjoks? Qit' situatë kena mri. Veç ishalla vetëdijësohen të gjithë.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Patëm m'u kthy te kjo pjesa e shkrimit në pejton që ka qenë, thatë që u bo me qëllim që me tregu për juve çfarë familje jeni...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po është e vërtetë. Në vitin 1964-ten në mars, isha t'u shku n'shkollë, takova me ni shok t'klasës edhe po m'pytë tha, "A ke marrën gazetën?" Thashë, "Nuk blejmë na gazeta. Pse ka diçka ni shkrim?" Tha, "Po", thashë, "mos për babën tonde?" Tha, "Jo për temin po për tanin". Ni muj ditë unë kom qenë, s'po di qysh me thanën, si simbol i Prishtinës. Si dilsha n'rrugë dikush m'kqyrke, me simpati, e bija e Ajetit. Dikush me urrejtje, po flas për shqiptarët. Po qaq kom qenë aktuale për ato ditë.

Ni muj ditë ka shkru Rilindja, 'Si u nxu Ajet Gërguri kryetar i ballistave të Kosovës?' Edhe *Večernje novosti* edhe Rilindja. Ni muj ditë. Bile kisha pasë dëshirë ndonjë gazetar m'u angazhu me gjetë me përsërit edhe nihere. Atë pejton me shkru edhe niherë ni muj ditë për ata. Bile ka pasë bo ni i Shqipërisë ni emision shumë t'mirë për babën tem mas luftës. 'I harruari' ia ka pasë qit' titullin. Se pak njerëz janë edhe na s'kena qenë fort tipa m'u imponu, jo kjo, jo kjo. Me pasë kanë dikush, o e bija Ajetit

ish konë deputete tash, po unë s'jom për ato sene. Kush e meriton le t'përparon. Ai pejton ka qenë shumë bujë në '64-ten.

**Anita Susuri:** Po megjithatë, ju thatë që jeni njoftu me bashkëshortin e juj edhe...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** A po. '66-ten nejse jena njoftu, '67-ten jena martu. Ky tasht i kanë thanë, "Ku don me feju vajzën e Ajet Gërgurit?" Ky i Malit të Zi ku e ka ditë kush osht' Ajet Gërguri. Këtu e ka kry normalen në Prishtinë, në Beograd fakultetin kështu që ka qenë jashtë ngjarjeve. U marrë me sport, s'i ka interesu fort politika.

A patriot është ma patriot se të gjithë edhe ka thanë, "Bash që osht' çika e Ajet Gërgurit, unë du me marrë për gru". Bojshim hajgare, "Qe kosovarët s'guxun me të marrë", thashë, "Edhe ti me fat i Malit të Zi", thashë, "'74-ten ra Rankoviqi, u ndrrun puntë krejt". Veç ajo pejtoni ka qenë për shkak, unë po të tregoj, se bash ia qëllon moshën kur ne të dyjat ishim për martesë.

**Anita Susuri:** E a është marrë edhe motra juj me kto aktivitete?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, motra ime ka kry vetëm klasën e pestë edhe ka thanë, "S'po du me shku në shkollë, du m'i ndihmu nanës me qepë", edhe e ka lonë.

**Anita Susuri:** Ajo me zanat është marrë.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po.

**Anita Susuri:** E pastaj dikun ma vonë kur jeni martu, po më duket, nuk e keni vazhdu ma aktivitetin apo edhe ma herët?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo prej që jom martu jo ma. Prej që jom punësu ma s'kom pasë aktivitete. Kështu me ndihmu ma tepër humanitare tonve kur kom mujtën. Kështu me politikë valla kur te kqyrsh edhe ata pak jom asi... '90-ten, '90-ten më duket kur na erdhën masat e dhunshme edhe drejtoresha e Beogradit e prun në Prishtinë. Ajo ka qenë profesoreshë shumë e mirë që ju ka dhanë ktyne shoqeve të mia. Se ato shoqet e mia e kanë kry në Beograd shkollën e naltë, unë në Zagreb.

Shumë profesoreshë e mirë kështu, pa e ngarkune politikisht. Po e kanë pru grunë t'u i thonë që, 'Atje s'po shkon puna mirë, e duhesh me rregullue punën', edhe ia kanë dhanë ligjet, kishe "Qita, qita duhesh me ba". Erdh aty ku punojshim na. Na shkrujshim latinisht edhe tha, "Jo duheni me shkru çirilicë", tha, "se qishtu osht' ligji".

E tash unë, a din, kur je e msune me folë, krejt u shukatën kërkush s'foli, mu s'më la zoti rahat. Thashë, "Po profesoreshë, s'ka problem. Unë e para shkruj çirilicë. Po le të ndrrohet statusi i Kosovës se status

të Kosovës shkrun ‘Ni gjuhë që mbahet prej popullatës me përqindje ma të madhe, duhet m’u shkru qajo ma së pari’. Këtu dihet që shqiptarë jemi ma shumë se serb”, asaj ia ktheva fjalën. Thashë, “Unë e para shkruj çirilicë, vetëm le ta ndrojnë ligjin. Le ta bijnë që çirilica është gjuhë zyrtare në Kosovë”, tha, “T’paska hi irridenti në kry”, thashë, “Larg asaj”, thashë, “unë s’mirrna me ato sene”, thashë, “vetëm po foli në bazë të ligjit të Kosovës”.

Pata lexu që nime, ku dominojnë popullata serbe ose shqiptare ma s’pari në qat’ gjuhë shkruhet. Te na dominojshin shqiptartë, kështu që ma s’pari shkrujshim latinisht ose shqip. I shtini receptat e barnave me shkru çirilicë. Kërkund nuk shkrun ajo, shkrun latinisht. Po ajo s’kish faj se i kish ardhë puna prej jashtë. Se ish shku ni mjeke jona, çka s’kish thanë në Beograd për to qysh p’i len shqiptarë me çu kry. E qata e di që, krejt u shukatën, unë apert thashë valla s’po shukatna, s’mujta m’u shukatë. Zaher rraja (qeshë).

**Anita Susuri:** Osh’t edhe ni pjesë e rëndësishme n’vitin ‘68 që ka ndodhë, janë demonstratat që kanë ndodhë ku për herë t’parë osh’t’...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po ‘68-ten, po, republikë, po. Unë qatëherë e kom pa lind vajzën. Djali i kunatit e dojsa i thojsha, “Dilni në demonstrata. Hajt bre edhe nëse ju qesin prej pune, unë ka me iu mbajtë”, isha në punë. Thashë, “Hajt dilni në demonstrata”. Kanë dalë, masive kanë qenë. Demonstratat kanë qenë atëherë për lavdata, krejt populli u dalë. S’ka qenë kërkush i ndam knej andej. Krejt kanë qenë.

Po unë e kom pasë gjithnji ni frikë, jom konë ni tip i çuditshëm edhe tash jom. Për shembull, krejt ato organizime dyshoj mos osh’t edhe dikush i përfshin. O’ negative veç të shtin ty me folë për me të burgosë. A din që qasi mendime kom shumë. Pa e njoftë njerin, pa i besu çka di unë ti me çfarë po del, me çfarë qëllimi. Se shumë janë burgosë njerëzit në atë kohë, shumë. Diqysh gjithë jemi frikë, për çdo organizatë që të bohet që a janë krejt njerëzit e pastërt ata që çojnë. Se shumë kush mendon ndryshe, vepron ndryshe.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet qajo ditë diçka prej qatyne demonstratave?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Valla u konë, i kom pa, se e kom pasë banesën përballë soliterit, t’u ikë rinia, t’u i rreh policia. Ikshin ku mujshin, me hi nëpër shtëpija. Se s’bijke larg, u kthejshin... shumë kanë rreh. Shqiptartë gjithë ju ka shku koha t’u u rreh.

**Anita Susuri:** E si kanë qenë për juve këto kur keni dëgju për burgosjet e për shembull edhe për burgosjen e Adem Demaçit, për vrasjet në burg për shembull? Qysh jeni ndje ju? Kanë qenë njerëz që i keni njoftë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Valla po. Bile qit' Fazli Grajçevcin bash e kom njoftë mirë. I shkreti i ri ka qenë. Djalë i Drenicës, mësus. Ka ardhë m'u shkollu po ka qenë patriot i madh ai. As ni fjalë s'e ka folë në burg ai, për qata ka vdekë ai. Se s'ka dashtë kërkond me qit'. A ka vështirë me dalë djali me të ardhë... edhe s'i kanë lanë fare xhenazen me ia çelën, arkivolin.

Se kur të vdes në burg ushtarë nuk t'lojnë me çelë se edhe ushtarët të gjithë kanë qenë, asnjë s'ka vdekë në mënyrë normale. Ja e kanë helmu, ja e kanë mytë, as ni shqiptarë s'ka dekë prej smujes. Masnej nisën oficerat shqiptarë m'i helmu. Që kanë qenë nëpër Nish, nëpër knej. Ka qenë luftë e msheft. Shumë rinia na ka vdekë nëpër burgje po s'i dijna.

**Anita Susuri:** A keni shku ju nëpër varrime për shembull? Të ktyne të burgosurve?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ja-a, ja-a, kom shku në të Ademit e ktyne kështu ku osht' normale. Valla kur u lëshu Ademi prej burgut në herën e parë, më duket krejt Kosova janë shku me pa. Pa marrë parasysh, edhe situata nuk u kanë bash e qetë atëherë po të gjithë kanë shkue. S'di a ka lanë kush pa shku me pa.

**Anita Susuri:** Edhe ju keni shku?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po. Atëherë ka qenë masive. Po shyqyr ke me jetë të gjatë e jetoj deri në 80 vjet.

**Anita Susuri:** E këto, na kanë tregu ma herët, që edhe kur kanë dalë prej burgut njerëzit edhe janë përcjellë edhe ata që po vijnë prej...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Vëllau jem bile kurrë s'ka qenë ni dalje në rrugë pa u përcjellë. Ai vazhdimisht... kur e ka kry burgun, fakultetin, ku me hi në punë edhe këta Jahnovt e Drenicës shumë na kanë dalë në ndihmë se edhe babën e kanë strehu shumë te ta. E a ka qenë kryetarë komune a çka ka punu njani i Janove, i ka thanë, "Konkuro në Glllogovc kishe s'po të njoh kush je". Atje u punësu për herë t'parë, masi u dalë prej burgut, si ekonomist. Masnej prej atyhit u bartë në Prishtinë.

Ai ka qenë shumë pedant për orar të punës. Fiks në ora 07:00, në dhetë në 07:00 shkojke në punë lexojke gazetë në ora 07:00 e mbyllke me ia fillu punës. Thojsha, "Vëllau jem, po të shtijnë në burg", edhe i mrami dilke. "Hiq..." se krejt spitali kërkush nuk u dalë në ora 03:00, dhetë n'03:00, 07:10 mrrijna n'punë. "Mos shko se vallahi t'marrin n'burg. Thojnë 'Çka po shkon ky kaq herët e çka po del kaq vonë'. Po rri, mos ju bazo orarit".

**Anita Susuri:** Zonja Shazije, ju në vitet '80-'81-ten domethonë keni qenë t'u punu sigurisht...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po.

**Anita Susuri:** Ka ndodhë edhe atëherë demonstratat në vitin...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, '80-'81.

**Anita Susuri:** Si i keni përjetu ju këto?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Atë, nuk e di, a ka qenë ma vonë kjo që jonë helmu fmija. Edhe ato katastrofë jonë konë. Ato jonë fillu nëse s'gaboj te Mensa e Studentëve. Qaty kanë fillu prej asajna... ato kanë qenë të planifikune veç janë kapë te pjabat që me nisë ti ata... edhe qajo '81-shi na pruni po më duket qitu me shku kah republika. Patën sukses. Ato kanë qenë shumë masive.

**Anita Susuri:** Ku keni qenë ju kur ka...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** N'punë kom qenë, n'punë, n'punë, n'punë.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet qajo dita qysh ka shku krejt? Qysh ka qenë qyteti? Në çfarë gjendje?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ka qenë katastrofë. Kastastrofë ka qenë. T'u ikë njerëzit, i kanë hapë njerëzit dyrtë me hi kush don që m'u strehu, mos me nxon dikond rrugës. Se kanë qenë student të jashtit. N'atë kohë kom pasë marrë unë, qitash ma kujtove, bile njo i Prizrenit m'duket ka qenë, a i fshatarve të Prizrenit, veç fshatarve që jetojnë në Prizren.

Djali e pat' marrë, se atëherë djali ka qenë student. I morëm studentat nëpër shtëpia për shkak se u mbyll mensa edhe u mbyllën konviktet. Qe krejt kom harru, tash ma kujtove. E mora ni djalë te shpija njo ni muj ditë e kom majtë. Se s'kishin ku me shku se kanë marrë shumë njerëz nëpër shtëpia. Studentat që kanë qenë jashta Prishtinës.

**Anita Susuri:** I kanë marrë për shkak se u mbyll apo për shkak se ka qenë rrezik?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo u mbyll. Me hongër s'kishin ku e sene edhe mensa u mbyll. Masnej bash ni i Prizrenit ka qenë ni djalë, emri s'më kujtohet, tash osht' në Gjermani ai djalë. Edhe ai ka qenë student në stomatologji me djalin tem edhe e kom marrë në shtëpi.

**Anita Susuri:** A ka pasë edhe tjerë që kanë marrë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, n'hymje tem jo veç ka pasë krejt, i kanë strehu s'i kanë lanë studentat rrugëve. Ua kanë çelë, sidomos këta me shtëpia, u kanë hapë dyrtë s'i kanë lonë rrugëve. Populli jonë është shumë bujar në këto raste. E rrezikon edhe vetën edhe s'i intereson ma tutje

përgjegjësinë pse e ka marrë. I kanë hapë dyrtë shumë. Për ata jena të mirë veç kur osht' puna me zgjedhë vendin, atëherë kem qef m'u shty pak a më takon mu a ty. Qaty se kështu jena bujar.

**Anita Susuri:** Me 1 edhe 2 prill kanë qenë ato ma masivet, demonstratat, ku janë bashku edhe populli punëtor që i thojnë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Këto minierat a?

**Anita Susuri:** '81-ten ende po flas. A keni dalë edhe ju?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo veç fmija, djemt. Jo unë jo. Qiky djali i madh ka dalë. Po dihet aty qysh u konë. Krejt ka qenë, krejt kanë... qaty zyrtarisht, hapun kanë thonë, "Republikë Kosova ja me hatër ja me luftë!" Qashtu u këndu n'atë kohë. Aty ka qenë haptas që e kanë lypur Kosovën me bo republikë.

**Anita Susuri:** Qysh ka vazhdu pas kësaj te ju n'punë me kolegët e tjerë? Bashkëpunimi si ka qenë? A u acarë pak?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kemi pasë edhe serb aty. Po shiqo, ky kabineti jem personalisht po flas, ka qenë si kabinet i mbyllur na s'jena shoqnu me të pavijonit. Veç ni serb e kena pasë të Prizrenit e cila e ka ditë shqipen shumë bukur. Me fëmijë ka folë shqip, të ushtrimeve. Kështu as ajo s'u shoqnu me serbët e vet. Na të katërtat veç kena nejt ndamas me këto. Ajo pak e kqyrshin me urrejtje ato serbet po kjo nuk i regjistrojke hiç, nuk dilke me nejt me to fare. Rrijke me ne.

Atëherë u ndan shumë, u ndan në grupacione, bojshin planet e tyne për ma tutje. Veç këta po më duket janë shumë ma të bashkun se na në raste të nevojës, shumë. Përlahen, shahen, çka osht' ni e zezë po kur vjen puna e vendimit, e marrin njejtë. Qajo.

**Anita Susuri:** Qysh kanë vazhdu pastaj qato vitet?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Vitet, qaty pak, s'po di a osht' kjo viti a cili osht' që dulen punëtortë prej pune?

**Anita Susuri:** '90-ta.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** A '90-ten domethonë a? Pak qaty kur i kanë qit' në rregull, po ku s'i kanë qit' unë gjithë jom konë që mos e lëshoni punën deri t'ju kapin përkrahi. Jo, jo s'e di a ka qenë në të '90-tat ky i sindikatës, Hajrullah Gorani që organizoj.

**Anita Susuri:** Për marshet diçka?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo, me lëshu punën, si grevë e pat’ organizu Hajrullah Gorani, sindikata. Po s’po di a ka qenë ‘80-ta a ‘90-ta, s’po m’kujtohet. Po unë i thojsha, “Mos e lëshoni punën. Çka ka lidhje?” Për shembull, i hjekshin drejtorin shqiptarë e ‘S’po du drejtorin serb me ndëgju’, “Po dëgjoje se e ki për hir të popullit se krejt pacientat janë shqiptarë, s’ki asni pacient serb. Aty ktu me dhanë dhetë vet, 20. Mos i lëshoni vendat e punës. E kur t’kapë për krahi atëherë n’rregull. Sa s’ju kapë për krahi...”

Po këta serbët e meçëm, e shprazën kirurgjinë se shqiptarë, “Jo se e hekën drejtorin shqiptarë e prun serb’, u çun, e lëshun punën vet. Kirurgjinë... gjinekologjinë ku ken’, ma s’shumti ku ka nevojë populli për kirurgji e... se për interno, për sy, krejt munësh m’i kry edhe n’shpi. Interno fort nuk qitën, veç kush dojke vet me dalë e gabun se veç për krahi kur t’më kapë. Ai për krahi s’kish mujtë me kapë krejt pavijonin, i kish kapë nja dy-tre vet.

Me rujt vendin e punës se lëndime kanë ardhë shqiptartë, të lëndun kanë ardhën edhe në gjinekologji gratë me lindë. Qato nuk jom për atë që e kanë lëshu punën. Se po ia bon favor dikuj hazër. Ai menzi ka prit me m’bo mu nervoz me lëshu punën. “Jo po punoni për shkije”, “S’po punoj për shkije, nuk osht’ vendi i shkijeve po vendi i Kosovës osht”. Unë çikën teme e kom pasë mjeke në interno, i kom thonë, “Me m’ngu mu nuk e lëshon”, tha, “Ti a je tranu? Krejt kanë shku veç unë me nejt”, thashë, “Unë me kanë në vend teje rri, le të shkojnë krejt”. Mos asi se vjen njeri që s’ka...

O’ kurrë s’e harroj ni gru, ‘90-tat atëherë kërseti, ‘99-ta a kur kërseti lufta, hala që s’ke, hala njerëzit u enshin rrugëve veç që krejt njerëzit e Kosovës u shpraz. Unë visha prej Ulpianës me pa nanën qitu. Kur një gru me kolic, kurrë s’e harroj atë detal, e shtyke djali i vet me çu në dializë në spital. Kuku, u tranova kur e pashë. Më tha, “A ki ni pikë ujë?” Prej asaj dites gjithë kom majtë ujë mas veti. Thashë, “Vallahi nuk kom”, thashë, “po ku po shkon more djalë i ri që si të hish në oborr të spitalit që nanën ta lëshojnë me shku në dializë ty t’mysin”, “E çka me bo?” T’u i sha mjekët vet me veti që e lanë dializën shkijeve.

Thashë, “Kqyr, ku ka me shku kjo?” Kurrë s’e harroj, e kom pytë vajzën, si ka ardhë mas luftës, ni gru qishtu qishtu e kom pa ia përshkriva tha, “Jo gjallë osht’. Na ka tregu që ka qenë në kohë të luftës në dializë”. E kurrë s’e harroj qat’ gru. Masnej ka vdekë ma vonë veç atë djalin çka m’u ka pasë dhimtë. 17 vjeçar e çojke nanën me kolicë prej Vranjevcit. Kit’ karrocën që e shtyn bërllugun, me to e çojke në dializë. E kur e ka çu, tash a ta bojnë mirë dializën, a s’ta bojnë, gjithçka duhesh me mendu. Se me të vërtetë edhe, ishalla, krejt serbët nuk janë njejtë me hi në gjynah me smujën. Qat’ rast m’kujtohet gjithë.

**Anita Susuri:** E ju a keni vazhdu punën?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Unë kom nejt deri gati kur kanë hy kështu asi, kom marrë fmitë në ushtrime. Veç kur s’kanë ardhë fmija atëhere jom nalë. S’më ka ngucë kërkush. Në kabinet temin e

asi... do pacientave ju ndihmojshim kur vishin prej syve që s'dishin ku janë, iu lajmërojshin prindërve që qaty i keni asi... shumë... m'duket që ka qenë para '90-tave që i ndrrun drejtorat që i lëshun kirurgjinë edhe gjinekologjinë, a po '90-tat qaty më duket ka qenë që masive dolën prej punave. Gorani prej sindikatave qato kur e ka pasë bo, nuk më kujtohet kur osht' viti. Ai e pat' organizu, "Mos shkoni n'punë", kishe si protestë. Ata e morën serbët, "S'ke ardhë në punë", edhe dhanë dorëhekje. Qajo.

**Anita Susuri:** A ju kujtohen këto marshet e minatorëve kur kanë fillu a pastaj...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Vitin nuk e di...

**Anita Susuri:** '88-ten.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** '88-ten a? Epo...

**Anita Susuri:** A po ju kujtohen këto?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo nuk di veç i kom pa në lajme se kështu diçka s'kom pa.

**Anita Susuri:** E vitet e '90-ta në përgjithësi si kanë qenë për juve? Si ka qenë atmosfera e vendit?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Unë rrisha në ballkon e nisa m'i bo do shkrime palidhje. Kur i shisha serbët t'u hi e t'u vjedhë nëpër shtëpija unë isha në banesë. Nisa m'i shkru numrat e targave të kerreve, masnej thashë, po kush ka m'i kqyrë kto numra, a jom tranu? Na shkum te [afër shkollës] "Hasan Prishtina", kanë pru diçka shumë me paketa, me paketa, me paketa. Masnej vishin i merrshin i çojshin... po flas për serbë. E kanë mush shkollën me diçka, e vishin i shprazshin me diçka. Paramilitar, paramilitar, paramilitar. Kuku qatëherë ka qenë tmerr.

**Anita Susuri:** Gjatë luftës keni qëndru këtu apo diku?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, këtu, këtu. Nana jem... jo në banesë teme nuk e kom pasë këtë shpi, mas lufte e kom marrë. Nana jem ka qenë shumë trimneshë, te motra ka nejt. Në rrugën tjetër ka parku ajo [rruga], perpara thirrej e Moraves. Tha, "Hijnë paramilitarët", ka magjup kojshi, përmi to janë konë magjupt. Tha... ata u gzojshin se bashkëpunojshin me serbët. "Nana jem", tha, "rat", tha, "i thashë, 'Çu, çu se po vij në serbët' tha, 'Po në ardhshin punë e madhe, çka kanë me na bo'", tha edhe asi... ata magjupt kanë thonë, "Këta janë turqeli, mos i ngucni fort".

Kur po çohet... s'jena konë turqeli po ai për me shpëtu, kojshi kishe. Se ai burri i vet katunar i Glllogjanit. Kur tha, "Hini aty mrena. Nana jem kadal po çohet: "Dobro jutro baka [srb.: Mirmengjesi gjyshe]" "Dobro jutro [srb.: Mirmengjesi]" thotë, "Çka po bon?" "Qe valla, jom ra qitu", "A po t'ngucë

kush?” Ka thanë, “Jo kërkush”, “Ani vazhdo e flej” (qeshë). Ata na hinë, “Çu, çu se po hijjnë”, “Ani more edhe n’hifshin çka kanë me na bo”. Se kishin pasë ngucë. Në banesë nuk kanë hi. Se te na veç dy shtëpija kena qenë në banesë krejt janë ikën.

**Anita Susuri:** A ju kanë largu prej banese apo?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo.

**Anita Susuri:** A ka ndodhë që keni ndrru vendin?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kena nejt bashkë me këtë, se di a e njeh këta, Spahinë e Prizrenit, me Spahinë e këta, me mësusen Emine, te ta kena nejt bashkë.

**Anita Susuri:** Diku n’qendër?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo në Ulpianë, përballë Shkollës “Hasan Prishtina”. Aty kena nejt e i kqyrshim. E kur hyn rusët, gjujshin qaty u frikësova hala që ishin me mu. A din pse u frigua, tash lufta u kry e dojshin fmija me dalë në dritare me kqyrë, jo t’mit. Dojshin me kqyrë në dritare. Thojsha, “Largohuni se po ju mytin, gjujshin rusët”. E thojsha, “Tash çka po fiton? Në fund të luftës po vdes”. Hala qeshin me mu, “U tut kjo kur hini rusi” (qeshë).

**Anita Susuri:** A ka qenë... më doket që ka pasë edhe problem për me siguru bukën e...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** A, veç na gratë shkojshim, unë edhe msusja Emine. Shkojshim në Ulpianë n’ren pritshim. Për bukë burrat s’i kena lanë me dalë hiç. Ni muj e gjysë mshelën kanë qenë. Ajo shumë gru e zoja ka qenë e ndjera, vdiq tash. Ajo ka pasë furnizu me krejt shpijen, me makarona, me oriz me këto gjana që t’majnë pak edhe pa bukë. Shkojshim qaty renin pritshim, merrshim bukë.

**Anita Susuri:** A ju ka ndodhë naj ngjarje ose diçka që keni pa?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po dalshim... qishut ju kom nxon për të madhe disa njerëzve prej Vranjevcit vishin knej rruge lypshin çaj. Bash ish mangu për atë çaj, m’i myt dikush, i merrshin edhe fmitë me veti. Tani dul nifar’ ligji, s’di a ishte gënjeshtër e dikujna, që me shku m’u lajmëru te parku dikun. Ish kishe ni zyre m’i marrë do numra, s’di çka thojshin. Thashë, “Hiqy tyne”, aty i mashtrojshin njerëzit, vishin pritshin në ren.

Kur u bojshim ren në Ulpianë, krejt t’ri. Thojsha, kuku qitash me gju ni bombë i rahatton. Se për veti e kisha moshën, 60 e kusur vjet. Thojsha, krejt këta rini shkojnë. A din sa ish reni i gjatë veç shqiptarë, aty-ktu naj serb. Qaty gjithë jom frikësue. Thojsha s’ju duhet shumë, kah t’kalon ni automat edhe që ish kanë tre-katër serb kurgjo s’ish bo, i myt 30 shqiptarë. Qaty gjithë jom frikësu, për bukë kur kom

pritë. Shumë i çojshin fminë me ble. Se edhe nuk i jepshin kah ni bukë, dy, e u dufshin me ardhë kah dy-tre vet prej ni shtëpije. S'po di çka me thonë, ka qenë tmerr për krejt.

**Latra Demaçi:** E ju thatë që vllau ka vdekë në vitin '99...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po në Gjermani.

**Latra Demaçi:** A ju kujtohet koha kur ka dalë prej burgut? Qysh e keni përjetu? A ka vazhdu përndjekja në atë kohë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo ai në vazhdim është përndjekë. Edhe këta të burgut janë sikur hajnat kur t'vjedhin e kur t'lypin diçka s'e gjen, i kapin krejt. Edhe krejt këta të burgosurit kur ka ardhë ndonjë delegacion prej Beogradit, e kanë pasë si obligim i kanë mbledhë i kanë burgosë edhe i kanë lëshu. Veç i kanë shti në burg që të mos bojnë diçka. Ajo ka qenë sikur adet me thanë. Krejt të burgosurit politikisht janë mbledhën, i kanë burgosë ni natë, dy derisa janë kry këto...

**Anita Susuri:** Si izolim.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Si izolim i kanë marrë ata janë konë të përndjekun, ata të burgosurit. Gjithnji vllau jem ka thanë, "Çdo hap e kom njerin që m'përcjellë edhe garant shqiptar". U konë tip që s'ka folë shumë. Boll m'jet marak që s'kom mujtë kurrë me ia marrë fjalën se kush osht' ai person. Se ai e paska ditë. Se ndoshta ai fryhet si ma patrioti tash. Unë jom për m'i qit' ata njerëz në mejdon, n'koftë edhe djali jem n'pytje, pse jo.

**Anita Susuri:** E '99-ten thatë që ka ndrru jetë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ka ndrru në Gjermani. Se...

**Anita Susuri:** Gjatë luftës ka qenë dikur apo?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, ai ka shku para luftës në Gjermani. Si jonë bo kVto trazira ai ka shku në Gjermani pa gru niherë. Ni djalë e ka pasë. Ma vonë i ka shku gruja qishtu për mali qysh kanë shku. Ka nejt refugjat dikund, kuku sa keq. Kur ka vdekë, se ai ka lind në Fier, edhe mos m'u vorros në Gjermani, prej Gjermanisë e kanë çu në Fier e kanë vorros. Vorrin me babgjyshin e vet. Se s'ka pasë vend. Atje osht' vorros. Veç ceremoninë fort mirë ia kanë bo në Shqipni. Se këtu s'ke pasë qysh me pru.

**Anita Susuri:** N'cilin vit ka qenë kjo?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** '99-ten, luftë ka qenë kur ka vdekë ai.

**Anita Susuri:** Luftë ka qenë a?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po, po.

**Anita Susuri:** Ju s'keni mujtë me shku?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo. S'e kena pa, dhetë vjet s'e kena pa. S'ka pasë as telefona si tash. I ri valla ka dekë, 63 vjet.

**Anita Susuri:** Ka qenë i smutë a?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, kish qenë, n'ciroz të mëlqisë. Atje në Gjermani po të tregojshin edhe kur ki me vdekë, mjekët. Ndaq prano ndaq mos e prano. Ai ka qenë shumë patriot. Atij s'i ka interesu pasurina, s'i ka interesu kurgjo. Atij veç kombi i ka interesu. Edhe me vdekë unë s'u konë ngusht. Edhe në burg kish hek shumë. Kuku çfarë malltretime ia kishin bo atina në burg.

**Anita Susuri:** Në cilat burgje ka qenë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Në Nish. Se i ka hangër dy, njo për babën njo për veti.

**Anita Susuri:** '99-ten thatë që keni qenë nonstop në Prishtinë po edhe pak para se me përfundu ose në përfundim të luftës m'tregut ni ngjarje që keni dalë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ajo ka qenë ngjarje pa arsye me hupë kokën. Shkum, se burri s'pat' dalë ni muj e gjysë. Hajde shkojmë n'postë, ndëgjum që po lshohen telefonat. Kur him aty mrena ishin konë do si të vesht, tash a paramilitar a çka kanë qenë, ulun. Dy sportele punojshin njo djathtas njo majtas. Burri shkoj majtas, tha, "Shko ti anej". Unë e pashë ni prishtinali këtu thashë hajt të shkoj te ai. Nuk i fola serbisht as turqisht po shqip. Thashë, "Kom ndëgju i kanë lëshu telefonat a?" Kur t'kanë kcy ata paramilitarët, nanën e babën ma shanë. Më thanë, "Këtu osht' Serbia, pse flet ti shqip?" Njani, si duket u çu me bo diçka fizikisht po tjetrin e kom dëgju kur ka thënë, "Lëre". Se ishim pak të moshum, s'ishim rini.

Tash e kisha frikën kur të dal prej ndërtesës që si t'dali na gjujnë jashtë. Thashë çka bom në fund të luftës shkum pa arsye. Kur dolëm jashtë, s'po guxoj me kthy kokën mrapa fare me kqyrë çka u bo. Ngjitem shkallave përpjetë. Kur erdhëm te posta te shkalltë naltë, u ndalëm me ni njeri me bisedu thashë, pa e kthy kokën me kqyrë çka po bohet. Kërkush s'na kish përcjellë. Atëherë shkum në shpi, thashë, "A që kem kah përfundojmë dy arkivole pa nevojë".

Se burri jem krejt kohën e brejke ndërgjegja me nejt... ky ishte atëherë nja 65 vjeç më duket. Me nejt unë në shtëpi. "Dil more shko lufto, kush po t'nalë?" Osht' shumë trim. "Dil shko lufto, kush po t'nalë?"

Unë rri vetëm a s'e kom njet me dalë prej Prishtinës". Unë frikacakja shumë jom konë pasë bo trimneshë. Unë si duket në raste ku duhet po trimnona. Po thom, bohet bohet edhe u kry. Ai ish shumë e brejke... edhe seriozisht i thojsha, "Shko lufto, rri vetëm kurgjo s'bohet".

Djemt i kom pasë, djalin e vogël e kom pasë në Austri, student. Djali i madh veç kish dalë refugjat. E qata me ju përshkrue, kurrë s'e harroj. E përcjella djalin tem edhe t'motrës se i lypshin për ushtri shumë. Me shku në Shkup me hyp në aeroplan e me shku për Slloveni. Ka qenë ni biletë e aeroplanit ni mujore m'u shëtitën, me nejtën si studenta. Rrugës t'u shku polic, polic, polic, unë u tranova. Po na ndalin këtu, po na ndalin këtu, po na ndalin.

Mrrijmë deri në Shkup diqysh. Këta të ritë kqyrë për dritare unë piskat, "Ulnë kokën poshtë". Kur mrrijmë në Shkup, kurrë s'e harroj atë moment, gjyna që s'di me shkru. Kish shqiptar, pleq, të prunë fminë m'i largu prej ushtrisë. S'kishe ku me qit' kamën prej njerëzve. Plot, plot, plot t'u i largu fminë e vet. Çka m'la përshtypje ni plak, ni fëmijë 15 vjeçar i katundit, i shkreti kurgjo s'dike. E çojke djalin veç me hekë prej ktuhit. "Ku p'e çon?" "Nuk di".

Tash këta fëmija e kishin biletën për aeroplan, nuk po ateron aeroplani. Shka me bo s'kisha pare me veti. A din qysh jom konë bo? Si ato lypset. Si e shisha ni ftyrë si të njofshme thojsha... për me nxjerrë biletën tash me shku tjetër vend. Te njerëzit që i njifsha që mujsha m'ju kthy paret. "A ki me m'i dhanë 500 euro?", 500 marka, "Jo s'ka", "A ki se m'kanë metë fëmija këtu?" Kërkush s'kish me m'dhanë me nxjerrë biletë për Zvicërr ose për diku tjetër. Po edhe ata s'kishin numrin e kufizun.

Thashë, "Hini në Shkup fleni se nashta nesër masnesër ateron". Nejtën në Shkup, kishin flejt ni natë në hotel edhe ata u frikësojsha m'i lanë. Kena pasë do fqinj të Prishtinës që u martu vajza atje në Shkup e thërras ata, fort mirë i kishin pasë pritë. Ai dhandrri, as nuk e njifsha kush osht', tha, "Mos u mërzitni, në qoftëse s'ka mundësi prej Shkupit me ateru, unë ka me t'i çu në Sofje fëminë edhe ka m'i hyp në aeroplan edhe mos u bo marak, fëmija kanë me shku për rrugë".

Qashtu ndodhi. Fëmija shkun prej Shkupit. Veç ai plaku me atë djalin kurrë s'mu ka largu mendja çka ka bo. Se apet fmija tanë kanë qenë të dalun e të shkollun e kanë shëtitë nëpër edhe përpara. S'janë konë që s'dinë m'u gjind. Po ai i moshun, djali 15 vjeç. Ka pasë raste për me kajtën e ato mos m'u ndalë rrugës t'u kajtë, se s'po din çfarë ndihme m'i dhanë.

**Anita Susuri:** A kanë arritë pastaj?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, djemt e mi kanë mrri kanë shku në Gjermani.

**Anita Susuri:** Prej Shkupit?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po prej Shkupit. Kanë shëtitë. T'pa lanë, të rrugës, t'u ndrru herë ni tren, herë ni tren. Tha, "Njana ike prej neve kur na shihke kështu, nifar' udhëheqëse ish kanë e ni fabrikës. Po kur hini", tha, "n'bisedë me ne, e pa që nuk jena rrebela, s'jena rrugaqa as kurgjo na ofroj", tha, "punë në fabrikë të sajna", tha, "se e pa që s'jem prej atyne që kena dalë me vjedh ose m'u rrugav", tha, "na ofroj punë n'fabrikë", tha, "sa i lam përshtypje", tha, "jena konë bo pa u la dy-tri ditë rrugëve". Ka shumë peripeti. S'osht' mirë m'i vajtu ato të kalunet.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet KFOR-i kur ka hy? A i keni pa?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo m'i pa s'i kom pa veç thom qajo rusi m'ka tutë shumë kur u hi (qeshë). Po fëmija janë knaqë, fëmija janë knaqë. Krejt nëpër dritare, krejt, kuku çka kanë bo fëmitë. Sa vjeç keni qenë atëherë?

**Anita Susuri:** Shtatë.

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** E vogël. E çka kanë bo fëmija prej gzimit, shumë, shumë.

**Anita Susuri:** Pastaj si vazhdoj për juve jeta? Jeni kthy në punë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po, po.

**Anita Susuri:** Kur jeni kthy? Meniherë?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Kur hini lufta meniherë si kanë hi KFOR-i, po mendoj NATO që e qetësoj situatën meniherë kena fillu punën. Spitali normal ka punue. Janë kthy edhe mjekt prej jashtit që kanë ikën nëpër Shkupa, nëpër knej janë kthy normal ka vazhdu puna.

**Anita Susuri:** Deri cilin vit kur jeni penzionu?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jom penzionu në 2009-ten më duket. Kur ken' këto helmimi i nxanësve?

**Anita Susuri:** Po, deshta me ju pytë...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Edhe aty ka pasë punë spitali shumë. Unë konkretisht jo se e kom pasë punën pak si të ndane, ju thashë, si kabinet ka qenë ai. Po pavijonet e këto ka pasë shumë.

**Anita Susuri:** A keni pa ndonjë rast?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Po plot, qe edhe djali jem ka qenë i helmum. Ky që osht' nalt. Ai ka qenë i helmum, ka qenë në gjimanz.

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë krejt?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Krejt nifar' si t'fikt, si histeri si ni agresiviteti. Që nuk mujshe m'i ra n'fije a osht' e vërtetë a mujshe me thanë mos po asi... po kumeditë çka ju kanë qit që mos me ditë çka po bon. S'kanë qenë të vetëdijshëm çka po bojnë. Piskatshin, gjeste të pakontrollune. Krejt ka qenë lidhje me sistemin nervor më duket. Qata e kanë pasë. Se kur ta çmendin mendjen sukcesi osht' ma i mirë, si me të qit' ni smundje. Mendjen e ki krejt. Kanë pasë fëmija shumë keq kanë qenë.

**Anita Susuri:** E qysh e keni kuptu ju që djali juj e ka? A ju kanë thirrë në shkollë a?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Jo, jo. Ka qenë në spital e tani kur u kthy m'ka tregu. Mas nja tri-katër ditë nuk e lash me dalë, a din, m'u izolu, psiqikisht m'u qetësu pak. Ai ka qenë i ri, t'dytën klasë a të tretën të shkollës të mesme. Po kanë qenë masive. Ato kah 100 vet n'ditë kanë ardhë n'spital. S'di motrat qysh kanë mujtë m'ju ardhë përreth. Aty janë angazhu krejt, krejt, krejt janë angazhu. Po nime jena popull i mirë. Kur kem kto raste s'kqyrim a osht' rasti jem a i joti a i kujna, veç m'i dhanë ndihmë. Për ata jena shembull për botën po për do sene tjera s'po mujna m'u pajtu (qeshë).

**Anita Susuri:** E djali juj qysh e ka përshkru? A ka pasë kështu mundim a diçka a?

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Qajo, mundim edhe dridhje. Dridhje kanë pasë shumë. Edhe me vjellë edhe, "Si shqetësim psiqik", tha, "u dridhshim". Aty kanë qit' diçka. Kanë qit' se qyre, e re i kom ndi që, nejsë kjo nuk është për inxhizim, masnej e flasim. Se nuk janë këto sene të përditshme.

**Anita Susuri:** Në rregull zonja Shazije, nëse keni edhe diçka që doni me shtu për fund ose që mendoni që keni harru...

**Shazije Gërguri Hasangjekaj:** Ju falënderoj që keni ardhë, që me ditë edhe rinia çka ka qenë e kalunja e njerëzve. Ishalla kanë sukses edhe përshëndetje, krejt politikant le të bashkohen.